



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 358, Datë 01.12.2023

MBI

**ZGJATJEN E AFATIT TË VENDIMMARJES SË BORDIT TË ERE-S NË LIDHJE ME
APLIKIMIN E SHOQËRISË “SWISS BALANCING POOL” SH.P.K. PËR LICENCIM
NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 14, pika 3 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 01.12.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2302/9 prot., datë 24.11.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi zgjatjen e afatit të vendimmarjes së bordit të ERE-s në lidhje me aplikimin e shoqërisë “Swiss Balancing Pool” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “Swiss Balancing Pool” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2302 prot., datë 17.10.2023, paraqiti kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 311, datë 30.10.2023, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 01.11.2023 dhe 02.11.2023) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 09.11.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.
- Me shkresën me nr. 2302/5 prot., datë 01.11.2023, ERE iu drejtua shoqërisë duke i njoftuar vendimin e fillimit të procedurës dhe duke i kërkuar plotësimin/saktësimin e dokumentacionit të konstatuar të pa plotësuar apo plotësuar pjesërisht. Kjo shkresë u kthye

nga shërbimi postar, me shënimin “I panjohur” ndaj në vijim ERE njoftoi shoqërinë nëpërmjet adresës së e-mailit nga vetë shoqëria, dërguar nga ERE më datë 07.11.2023.

- Në mbledhjen e planifikuar të bordit të ERE-s nr. 61 datë 01.12.2023 shoqëria me shkresën me nr. 2302/7 prot., datë 23.11.2023, ka depozituar dokumentacion plotësues për aplikimin e saj, pasi është njohur me vendimin nr. 311/2023 në faqen zyrtare të internetit të ERE-s. Ky dokumentacion u dorëzua përpara shqyrtimit të relacionit me nr. 2302/3 prot., datë 24.11.2023, nga bordi i ERE-s.
- Për shkak të kohës së pamjaftueshme për të shqyrtuar dokumentacionin e depozituar nga shoqëria në kuadër të plotësimit të dosjes së aplikimit dhe nevojës që mund të lindi për ndonjë korrespondencë të mundshme pas shqyrtimit të dokumentave, vlerësojmë të zgjatet deri në 30 (tridhjetë) ditë afati i vendimmarrjes së bordit mbi aplikimin e shoqërisë “Swiss Balancing Pool” sh.p.k. për t’u licencuar në veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike.
- Në nenin 14, pika 3, të Rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, parashikohet se bordi mund të vendosë rast pas rasti për zgjatjen e afatit për marrjen e vendimit përfundimtar për pranimin ose refuzimin e aplikimit për licencë kur dokumentacioni nuk është i plotë, por jo më shumë se 30 ditë.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin për marrjen e vendimit përfundimtar për aplikimin e shoqërisë “Swiss Balancing Pool” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “Swiss Balancing Pool” sh.p.k. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI